



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 40 të Ligjit Nr.2004/18 për tregtinë e brendshme neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE TË BIZNESIT NË QYTETIN E
LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet zgjatja e orarit të punës për subjektet e biznesit në lëmin e tregtisë dhe hotilerisë (restorantet, motelet, kafiteritë) të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të qytetit të Lipjanit.

Neni 2

Zgjatja e orarit të punës bëhet për sezonën verore dhe fillon prej datës 13.06.2016 deri më 15.09.2016, ku subjektet e lartëcekura mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre deri në ora 00:00, periodë e cila ndërlidhet edhe me fluksin e ardhjes së bashkë atdhetarëve nga diaspora.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

Neni 4

Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektorat i Komunës së Lipjanit.

1Nr. 130-30623

Lipjan, më 07.06.2016

